

# KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

## (<https://klp.al/>)

AKTIVITETE

([HTTPS://KLP.AL/CATEGORY/AKTIVITETE/](https://klp.al/category/aktivitete/)) / PËR  
MEDIAT ([HTTPS://KLP.AL/CATEGORY/PER-MEDIAT/](https://klp.al/category/per-mediat/))

## Këshilli i Lartë i Prokurorisë emëron znj. Manjola Kajana në Prokurorinë e Posaçme

📅 POSTED 13/07/2020 ([HTTPS://KLP.AL/2020/07/13/KESHILLI-I-LARTE-I-PROKURORISE-EMERON-ZNJ-MANJOLA-KAJANA-NE-PROKURORINE-E-POSACME/](https://klp.al/2020/07/13/keshilli-i-larte-i-prokurorise-emeron-znj-manjola-kajana-ne-prokurorine-e-posacme/)) 👤 KLP  
([HTTPS://KLP.AL/AUTHOR/KLP/](https://klp.al/author/klp/))



Në kushtet e pandemisë COVID19, është mbajtur gjatë paradite mbledhja e 63-të e Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Mbledhja është organizuar si gjithnjë në praninë e të gjithë anëtarëve të Këshillit dhe përfaqësuesëve nga Ministria e Drejtësisë, EURALIUS, OPDAT si dhe vëzhguesë të tjerë të akredituar.

Pasi ka verifikuar plotësimin e të gjitha kushteve dhe kritereve të parashikuar në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, në referencë të vendimit të tij, nr.137 datë 16.07.2019 “Për miratimin e listës me renditjen e kandidatëve për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme”, si dhe të Vendimit të KPA-së , datë 10 korrik 2020, për lënien në fuqi të vendimit nr.162 datë 19.06.2019 të KPK-së “Për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit znj. Manjola Kajana”,

Këshilli ka vendosur unanimitisht emërimin si prokuror në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe krimin të Organizuar (SPAK) znj. Manjola Kajana për një mandat 9 (nëntë) vjeçar pa të drejtë riemërimi.

Me emërimin e saj, SPAK ka aktualisht në strukturën e tij 13 prokurorë nga lista e 15 prokurorëve të zgjedhur nga Këshillin i Lartë i Prokurorisë. Me këtë rast, kryetari Gent Ibrahim i bëri edhe një herë thirrje organeve të Vettingut për të përshpejtuar afatet për verifikimin e figurës, pasurisë dhe aftësive profesionale për dy prokurorët e mbetur, Anton Martini dhe Elizabeta Imeraj, pjesë e listës së sipërpërmendur.

Ditën e nesërme, e martë 14 korrik 2020, pritet të zhvillohet edhe ceremonia e betimit përpara Presidentit të Republikës së Shqipërisë, zotit Ilir Meta.

← SEANCA PLENARE NR.63

([https://klp.al/2020/07/13/seanca-  
plenare-nr-63/](https://klp.al/2020/07/13/seanca-plenare-nr-63/))